



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

**DREJTUAR BANORËVE TË BASHKISË KAMËZ DHE TË GJITHË PALËVE TË
INTERESUARA.**

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr. 146/2014 “ Për njoftimin dhe konsultimin publik” në nenin 9, pika 1, 3 , të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore neni 18, në rregulloren e Këshillit Bashkiak, për konsultimin publik”.

Ju njoftojmë se konsultim publik do të zhvillohet mbi këtë temë:

HARTIMIN E PLANIT VENDOR PËR BARAZINË GJINORE

Ftojmë të gjithë grupet e interesit si: banorë të Bashkisë Kamëz , administratorët e njësive dhe lagjeve administrative të Bashkisë Kamëz, ndërlidhës të lagjeve administrative, biznese, grupet e marxhinalizuara, të rinj/ të reja, shoqërinë civile, etj., të bëhen pjesë e kësaj dëgjese për një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Konsultimi publik do të zhvillohet sipas kalendarit të mëposhtëm:

Data: 11.08.2025

Ora: 10:00

Vendi: Qendra Multifunksionale, Valias i Ri

Ky takim ka si qëllim kryesor bashkëpunimin dhe mbledhjen e rekomandimeve, të cilat do të shërbejnë për hartimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore.

Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete, të cilat mund të dërgohen në adresën e mëposhtme të e-mailit:

-konsultim.publik@kamza.gov.al Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Kjo dëgjese do të zhvillohet në bashkëpunim me Bashkinë, Njësitë dhe Lagjet Administrative të Bashkisë Kamëz, Anëtarë/përfaqësues të Këshillit Bashkiak Kamëz.

Jeni të lutur të merrni pjesë, pasi pjesëmarrja juaj është shumë e rëndësishme.